



INSTITUTI I STATISTIKAVE

**AGJENCIA SHETETËRORE PËR
MBËSHETJEN DHE ZHVILLIMIN E
STARTUP-eve DHE LEHTËSUESVE**

Nr. 133/ Prot., datë 01.04.2026
2

Nr. 177 Prot., datë 01.04.2026

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

Ndërmjet:

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
në vijim referuar si “INSTAT” dhe

**AGJENCISË SHETETËRORE PËR MBËSHETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-
EVE DHE LEHTËSUESVE**

në vijim referuar si “Startup Albania”

1. QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve (Startup Albania) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT), me synim krijimin e një baze të qëndrueshme për matjen, analizimin dhe vlerësimin e kontributit të startupe-ve në zhvillimin ekonomik të vendit.
2. Ky bashkëpunim synon rritjen e kapaciteteve analitike, mbështetjen e hartimit të politikave publike të bazuara në evidenca dhe përmirësimin e transparencës për aktorët e ekosistemit të inovacionit dhe sipërmarrjes.

2. OBJEKTI

Objekti i këtij Memorandumi është përcaktimi i mënyrave dhe formave të bashkëpunimit ndërmjet palëve në fushën e mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave statistikore mbi startup-et dhe lehtësuesit e tyre.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, palët do të:

1. Hartojnë dhe zbatojnë protokolle për shkëmbimin dhe analizimin e të dhënave lidhur me aktivitetin ekonomik të startup-eve;
2. Realizojnë studime dhe anketime statistikore për vlerësimin e impaktit të politikave mbështetëse;
3. Përgatisin raporte periodike mbi trendet e ekosistemit të inovacionit dhe sipërmarrjes;
4. Harmonizojnë proceset e raportimit me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare (Eurostat, OECD, etj.).

3. FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

1. Analiza statistikore dhe ekonomike – për matjen e ndikimit të startup-eve në ekonominë kombëtare dhe për identifikimin e sektorëve me potencial të lartë inovacioni.
2. Zhvillimi i metodologjive dhe indikatorëve – për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe raportimi të aktivitetit të startup-eve.
3. Kërkime dhe studime të përbashkëta – për vlerësimin e efektivitetit të programeve të mbështetjes ndaj startup-eve dhe lehtësuesve.
4. Shkëmbim informacioni dhe asistencë teknike – për përdorimin optimal të të dhënave statistikore në mbështetje të politikave publike dhe vendimmarrjes strategjike.
5. Promovim dhe publikime të përbashkëta – për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rolin e startup-eve në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e klimës së inovacionit.

4. SHKËMBIMI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT

1. Palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacionin për qëllimet e këtij Memorandumi duke ruajtur konfidencialitetin.
2. Shkëmbimi i informacionit sipas kushteve të këtij Memorandumi, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat dhe mekanizmat në fuqi të palëve.
3. Asnjëra palë nuk do të shpërndajë informacionet e marra nga Pala tjetër sipas përcaktimeve të Këtij memorandum, te asnjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
4. Palët do të zbatojnë mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
5. Palët do të caktojnë një person kontakti përgjegjës për komunikimet ndërmjet Palëve në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.
6. Çdo aktivitet i përbashkët që përfshin pronësinë intelektuale do të dakordësohet me shkrim nga Palët për të mbrojtur interesat përkatëse.

5. NDRYSHIMI DHE PËRFUNDIMI

1. Ky Memorandum lidhet për një kohë të pacaktuar dhe është subjekt i ndryshimeve vetëm me konsensusin e të dyja palëve.
2. Secila palë mund ta përfundojë Memorandumin duke lajmëruar me shkrim palën tjetër 30 ditë para.
3. Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.

6. HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij nga palët.
2. Memorandumi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR
INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

LANTONA SADO

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



**PËR
AGJENCINË SHTETËRORE PËR
MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E
STARTUP-eve DHE LEHTËSUESVE**

ARJAN YMERI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

